



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.12.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë pune e Komisionit në Institutin e Zhvillimit të Arsimit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Almira Xhembulla, Adelina Rista dhe Bujar Çela.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

Prezent:

Gerti Janaqi - Drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit.

Përfaqësues të stafit të IZHA-së:

Dorina Rapti - drejtore e Drejtorisë së Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit,

Astrit Dautaj - shef sektori i Sektorit të Kurrikulës,

Irida Sina - drejtore e Drejtorisë së Metodogjisë dhe Teknologjisë në Mësimdhënie,

Mirela Gurakuqi - shefe e sektorit të Teknologjisë në Mësimdhënie,

Albana Markja - shefe në Drejtorinë e zhvillimit të Politikave Arsimore.

HAPET MBLEDHJA

Gerti Janaqi - Mirëdita!

Ju falënderoj edhe në emër të kolegëve për vizitën që po zhvilloni, si Komision parlamentar për Edukimin, në Institutin e Zhvillimit të Arsimit.

Të pranishëm kemi edhe një pjesë të stafit. Dorina është drejtoreshë e Kurrikulës.

E mban këtë post prej dy vjetësh. Drejtori aktual ka qenë një nga menaxherët më të mirë që ka pasur arsimi dhe për fat instituti ka pasur një përzierje brezash: ka pasur njerëz që kanë dalë në pension para 2 vjetësh dhe e kanë filluar punën që në vitin 1982, që do të thotë se e kanë njohur edhe sistemin e mëparshëm, por edhe një pjesë të trajnimeve mbi reformën në arsim i kanë marrë pas viteve '90-të.

Dorina ka shef sektori Astritin, që përbëjnë komponentin kryesor të Departamentit të Kurrikulës.

Në anën tjetër, kemi Iridën që është drejtoreshë për IT-në dhe Metodologjitë e Reja, Albana mbulon Drejtorinë e Politikave, ndërsa Mirela, bashkëshortja e zotit Guraluqi, që ju e keni koleg në parlament, është shefe sektori.

Unë do të thosha që të gjithë këta janë persona që kanë punuar me një intensitet shumë të lartë, edhe prej faktit që ne e filluam reformën për arsimin parauniversitar në vitin 2013, dhe nuk janë vetëm këta, por do të theksoja se pa mbështetjen e ministres së Arsimit, ky institucion i varësisë nuk do të kishte mundësi të ishte kreativ dhe të shpaloste të gjithë potencialin e tij për të përmirësuar reformën në arsimin parauniversitar. Kemi pasur mbështetje të jashtëzakonshme, për hir të së vërtetës, nga Ministria e Arsimit.

Instituti ka një traditë të vjetër, siç ju thashë, ka pësuar disa ndryshime, duke filluar nga viti 1965 e deri në ditët e sotme. Ka filluar dikur me 5 punonjës, është quajtur Instituti i Studimeve dhe i Botimeve, ndërkohë që sot që flasim, pavarësisht oshilacioneve ndër vite, jemi 27 punonjës. Është pjesë e rrjetit europian të Instituteve të Kurrikulës dhe Trajnimeve. Ne marrim pjesë në 4 sesione vjetore në rrjetin europian të homologëve tanë, me shtete shumë prestigjioze dhe kjo na ka lehtësuar ndërveprimin për të kuptuar se si zhvillohen reformat në shtete të caktuara. Një pjesë e homologëve tanë nga Skocia, Austria i kemi ftuar edhe në Shqipëri, për të na lehtësuar të gjithë procesin e reformës në arsimin parauniversitar.

Sot që flasim ne kemi marrëveshje bashkëpunimi në dy këndvështrime: të asistencës teknike, të burimeve njerëzore, por edhe të asaj financiare.

Në materialet që keni përpara do të shikoni se kur na duhet të masim performancën e sistemit parauniversitar, kemi nevojë për një sy të jashtëm, për të kuptuar se si po ecën një reformë, aktivizojmë ose ekspertë të UNESCO-s, ose të UNICEF-it. Edhe me Fondin Amerikan kemi pasur bashkëpunim, ata kanë lehtësuar Shkollën e Drejtorëve. Ju ishit edhe në inagurimin e saj. Kanë pasur bashkëpunim me ne, sepse projekti pilot i Shkollës së Drejtorëve është pilotuar prej tyre. Ishin personat e institutit që e piketuan fillimisht dhe, më pas, u bashkëpunua për ta menaxhuar financiarisht me asistencë dhe me të gjitha gjërat e tjera.

Kemi marrëdhënie me Këshillin e Europës, Astriti është një nga personat që raporton në Këshillin e Europës, por edhe kolegët e tjerë, duke përfshirë edhe veten time, jemi pjesë e raportimeve në Bruksel. Nominohen grupet e punës nga ministri, ku raportojmë për çështje të arsimit pauniversitar, për kapitujt 24 dhe 25, në mos gaboj.

Fushat kryesore të veprimtarisë, ne i kemi për hartimin e kurrikulës kombëtare nga mosha 3-18 vjeç, nga kopshti, arsimi bazë, arsimi mesëm deri në fund të gjimnazit. Kemi një target specifik që është zhvillimi profesional i mësuesve dhe i drejtuesve; kjo do të thotë trajnimi i mësuesve që janë në sistem. Kemi mbështetjen e institucioneve arsimore me materiale, dokumentacione; po punojmë me universitetet ku formohen mësues, duke i asistuar ata në krijimin e kurrikulës së re që po përgatisin, sepse çfarë ndodh? Ajo çfarë prodhon sot universiteti nuk është në përshtatje me kurrikulën shkollë. Një mësuesi që diplomohet sot, i duhet rreth 5 vjet të kuptojë se çfarë ndodh konkretisht në shkollë.

Kjo është një reformë e vështirë; ne e kemi parë në Europë. Ministria e ka mbështetur dhe janë krijuar rreth 16 grupe pune me pedagogë, në mënyrë që edhe në respekt të ligjit “Për arsimin e lartë”, kurrikulat e formimit fillestar të mësuesve të unifikohen dhe në çdo grup pune ka një person nga IZHA-ja. Ky i fundit është konceptuar në mënyrë të tillë që një specialist të mbulojë një profil. Jemi në mungesë, për shembull, me 3 profile që në qasjen time duhet të plotësohen, ndoshta me organikën e re. Kemi pasur problem për sportin. Nuk kemi një specialist të mirë të sportit, pavarësisht se kemi pasur mbështetjen nga ministria. Meqenëse sporti është 3 orë sot në një pjesë të programeve që prodhohen, ne i rekrutojmë personat nga Ministria e Arsimit ose nga Universiteti i Sporteve, ashtu siç kemi boshllëqe edhe për kiminë apo për 2-3 profile të tjera.

Në fushën e arritjeve kombëtare, edhe kur ne kemi raportuar në parlament, para jush, si pjesë e ekipit të ministres, sepse është ministria ajo që bën raportimet kryesore, kemi disa arritje nga viti 2013 deri në vitin 2018. Unë jam përpjekur t’i rendis, por nuk do

t'i lexoj, për të mos ju marrë kohë dhe për ta zhvilluar takimin në formë bisede; do t'i gjeni në broshurat që ju dhamë.

Milva Ekonomi - Jo, nuk ka gjë, mos e lexo, se i kemi përpara!

Gerti Janaqi - Është një densitet i jashtëzakonshëm, sepse ka edhe një sërë pjesësh të shkollave të cilat ndoshta publiku i gjerë nuk arrin t'i konceptojë, për shembull kur themi arsimi për fëmijët e ngjuar, për fëmijët e shansit të dytë, që janë fëmijët që kanë probleme riedukimi, shkollat social-kulturore, shkollat sportive, muzikore e të tjera. Po t'i përmbledhim në harkun e 5 vjetëve, janë hartuar 560 programe të reja, 24 module, janë 1 mijë tryeza studimi, rreth 1500 persona janë bashkëpunëtorë të institutit. Kam parasysh këtu edhe njerëzit që angazhohen kur ne bëjmë portalin "Mësues për Shqipërinë", testin e kualifikimit e kështu ma rradhë.

Një nga debatet më të mëdha që kemi pasur, edhe ju e keni ndjekur, ka qenë trajnimi i mësuesve. Ministria ka pasur një presion të jashtëzakonshme për ta pezulluar trajnimin e mësuesve deri para 2 vjetësh, sepse ka qenë totalisht skemë korruptive, ndërkohë që sot kemi një skemë të re, e cila funksionon, monitorohet edhe nga Ministria e Arsimit, edhe nga ne, por është edhe e digjitalizuar. Thjesht për të qenë pak a shumë në vija të përgjithshme, për të krijuar një ide, ne kemi bërë një skemë, që do ta prezantojmë dhe në datën 11, edhe ju keni ftesa, janë dy komponentë kryesorë se si kryhet trajnimi i mësuesve në Shqipëri.

E para, është besimi që qeveria i jep universiteteve, ku formohen mësuesit, pra akreditohen qendra pranë universiteteve ose pranë institucioneve private të besueshme. Me këto të fundit kam parasysh Aleancën Franceze ose *British Council*, që janë organizma të huaja të atashuara pranë ambasadave, që ofrohen me ekspertizën e trajnimeve.

Nga ana tjetër është buxheti i shtetit që mbulon një pjesë të trajnimit të mësuesve në masën 86%, ku trajnimi buron nga IZHA-ja, nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, ke rrjetet profesionale. Me rrjet profesional kuptojmë 1043 drejtues, mësuesit më të mirë të çdo qyteti, të cilët me udhëzimin e ministrit do të duhet të trajnojnë 2-3 të tjerë; dikur quheshin formatorë, përpara viteve '90-të. Është ajo lloj skeme dhe zbret deri poshtë, sipas fushave respektive që ju i keni edhe në prezantim.

Portali i trajnimeve është i ndërtuar në mënyrë të tillë që çdo mësues ose çdo i interesuar mund të klikojë, mund të shënojë emrin e tij, të regjistrohet *on line*. Kjo na jep mundësinë të kuptojmë se ku e merr shërbimin, në çfarë ore ofrohet ai, në cilën sallë, në cilin qytet dhe në cilën datë, në mënyrë që ta monitorojmë. Sfidë është që edhe certifikatat që do të marrin mësuesit të gjenerohen elektronikisht. Nëse trajnimi përfundon, edhe certifikata

do të jetë në sistemin elektronik. Një reformë në arsim është shumë e vështirë, sepse zgjat minimalisht 15-18 vjet, të paktën këtë gjë e thonë ekspertët. Ne jemi në vitin e 5-të të saj. Nëse do ta përshkruaja shumë thjesht, është si puna e një ndërtimi, ku kemi ndërtuar kolonat, këtu kam parasysh të gjithë dokumentacionin e shkruar, por tani fillon pjesa më e vështirë. Kjo do të thotë zberthimi i mikrodetajeve, për të sqaruar akoma më mirë mësuesit, prindërit dhe nxënësit. Prandaj fokusi i trajnimeve ka qenë në ngritje, kërkesë e vazhdueshme edhe e ministres, por edhe e përvojës që kanë këtu njerëzit. Ne kemi bërë një trend në vite se si shkon numri i të pranuarve, i kemi me *database* elektronike, të certifikuara, janë pa pagesë, ofrohen nga buxheti i shtetit, nga taksapaguesit tanë. Kemi arritur që në harkun e 5 vjetëve të digjitalizojmë të gjithë fokusin se ku kanë shkuar paratë e shqiptarëve, se si janë trajnuar mësuesit, kush është trajnuar dhe në cilat fusha. Ky është një proces shumë i rëndësishëm, sepse çdo mësues që mbush 5-10 apo 20 vjet duhet t'i nënshtrohet këtij testi, për të fituar kategorinë e parë, të dytë apo të tretë dhe merr edhe një bonus, rritje të pagës. Është një test të cilit 3500 mësues, mesatarisht, i nënshtrohen çdo vit, dhe që ndahet në dy procese: në dosjen që vlerësohet nga drejtoritë arsimore dhe testi, më pas, për 24 profile, që hartohet nga specialistët.

Një nga elementët, ndoshta edhe për kureshtjen tuaj, mënyra se si hartohet një test nuk do të thotë, për shembull, që Astriti që mbulon edukimin qytetar, është i vetëm në hartimin e testit. Në procedurat, standardet dhe rregulloret tona, ne duhet të marrim minimalisht 3 bashkëpunëtorë për të hartuar një test. Këta të fundit janë zakonisht ose pedagogë të atij profile, ose mësues me një përvojë, që në gjuhën tonë i quajmë bashkëpunëtorë.

Janë 4 veta që prodhojnë një test. Më pas, testi certifikohet dhe hidhet në përdorim. Ky është një test që bëhet në letër. QZHA-ja menaxhon provimin e licencave.

Këtë vit, kemi reklamuar si një arritje, për të na lehtësuar ne, kanë digjitalizuar portalin “Mësues për Shqipërinë”, sepse e kemi menaxhuar ne për rreth 4 vjet, por pyetjet e portalit “Mësues për Shqipërinë” i prodhon IZHA-ja dhe më pas eksportohen në QZHA, në mënyrë që ai të shndërrohet në një test elektronik, ku prodhohet në kohë reale përgjigjja, sapo të përfundohet testi.

Për formimin fillestar të mësuesve, unë e preka pak më parë, ne jemi të angazhuar në reformën “Formimi fillestar i mësuesve”. Ju jeni dëshmitarë të disa vendimeve të Këshillit të Ministrave, për shembull, rritja e kriterit të notës hyrëse; duhet të kesh notën 7 të hysh në universitet për t'u bërë mësues.

Sot janë 164 pedagogë që po punojnë për të ndryshuar kurrikulat e mësuesisë. Ky do të jetë një proces që unë besoj se do të zgjasë edhe vitin tjetër, për ta unifikuar të gjithë kurrikulën e “Formimit fillestar të mësuesve” në të gjithë Shqipërinë.

Ndërkohë, ne kemi një veçori që edhe në VKM-në ekzistuese, por edhe draft VKM-në e re që pritet të dalë në fund të dhjetorit, si institut jemi në funksion të ministrit, në sensin që çdo politikë e shkruar nga ministri i Arsimit vjen në Institutin e Zhvillimit të Arsimit, flas gjithmonë për fushën e arsimit parauniversitar, për t’u zbërthyer në elemente teknike.

Një pjesë të nismave i kemi diskutuar edhe në komision me ju. Këto nisma janë prodhuar politikisht ose si drafte strategjike nga ministria, por janë përkthyer teknikisht nga IZHA-ja.

Keni edhe një përmbledhje të raporteve, konferencave, botimeve në media. Ne jemi përpjekur të vendosim ato më pikantet.

Ndërkohë që, nuk po ndalem te nismat, se i kemi diskutuar disa herë në parlament, te procesi i digjitalizimit ne kemi ndërtuar një faqe që, unë besoj, edhe nga matjet që bëjmë, është ndër faqet më aktive për arsimin parauniversitar.

Kemi një kanal në *youtube*, në bashkëpunim me mësuesit, ku për ta lehtësuar procesin, promovojmë orë model të xhiruara në shkolla, të gjitha këto janë me ndihmën dhe asistencën e huaj, pra ne nuk shpenzojmë nga buxheti për të bërë xhirime, por kur flasim për një reformë, një pjesë e mësuesve duhet të dinë se si bëhet një orë. Pra, kemi arritur te kjo pjesë, nuk diskutojmë më materialin teorik, por kërkesa është për gjëra më praktike dhe sigurisht kemi edhe *databazet* që ne i monitorojmë, për shembull, në harkun e muajve janar deri në përfundim të vitit akademik, që i bie diku nga qershori, faqja jonë ka rreth 850 mijë përdorues dhe jemi në monitorim të vazhdueshëm edhe të statistikave nga bashkëqeverisja; nga platforma “Shqipëria që duam”, herë pas here ne marrim *feedback*. Për shembull, kemi disa komente ku na kërkohet krijimi i një forum për të dhënë pyetje dhe përgjigje, por nuk e kemi pasur të mundur edhe për hir të kapaciteteve.

Kemi, pastaj, nismat e tjera që i kemi ndërtuar me bashkëpunëtorë të tjerë, për shembull, kemi faqen e shkollës “Qendra komunitare”. Ka qenë një nismë e hershme. Sot ka një portal që është mirataur nga ne. Shkollën e menaxhojnë vetë dhe shpërndajnë informacionin për shkollën “Qendra komunitare”. Kemi një platformë për orët e kodimit, e ndërtuar nga Fondi Amerikan, përsëri në bashkëpunim me IZHA-në.

Pra, jemi përpjekur që edhe në fushën e teknologjisë së informacionit të jemi kreativë.

Ky ishte një prezantim i shkurtër i IZHA-së. Një pjesë të botimeve ne i kemi digjitale, edhe për faktin se prodhimi i kopjove të tyre ka kosto dhe kemi gjykuar që ato që janë më të rëndësishme, mund të botohen, ndërsa pjesa tjetër janë format *pdf* dhe shkarkohen.

Fidel Ylli – Që në fillim të prezantimit tuaj, ju thatë se kemi pasur një mungesë eksperti në sport.

E para, unë mendoj se ne kemi bërë një reformë shumë të mirë për sportin në mandatin e kaluar, ku kemi përfshirë orët e mësimi, pra sportin nuk e pamë si një garë, por e pamë si edukim, që largon të rinjtë nga droga, nga alkooli, nga duhani, nga veset e këqija, me qëllimin që të jetë një rini më e shëndetshme. Në këtë aspekt kjo reformë, në një parashikim që ne bëmë, do të shtonte mësuesit e edukimit fizik për 9 vjet, duke hapur vendet e punës, pa llogaritur ata që dalin në pension, do të shtoheshin 1200 mësues të edukimit fizik.

E dyta, mendoj se klasat sportive do të shtoheshin nëpër të gjithë këto shkolla apo palestra. Unë mendoj se ne kemi një ngrirje dhe kjo reformë nuk po funksionon ashtu siç e ka menduar grupi i punës, i cili ia paraqiti qeverisë dhe parlamentit, i cili e votoi me konsensus.

Unë mendoj se ministria e ka kuptuar gabim këtë, që një orë mësimi që shtohet, ajo orë mësimi quhet klasë sportive. Absolutisht, jo. Ora e mësimi, pra është minimalja që e ka Europa 3 orë në javë, dhe ne kemi bërë të ligjshme 3 orë në javë, pra meqë sporti ishte pjesë e arsimit, kemi ndërhyrë në kurrikul, përveç ligjit të arsimit, kemi futur edhe këtë pikë, që e kemi vënë 3 orë.

Unë mendoj se këtu nuk ka vëmendjen e duhur ministria dhe ju, ndoshta, si institucion duhet ta shikoni si prioritet zhvillimi me ekspertë. Është një nga pikat që ju e keni edhe në funksionimin tuaj si institucion, që në këtë reformë që bëmë, nuk po ndihet ajo lëvizje që këta mësuesit e edukimit fizik të dalin dhe duhet një bashkëpunim ndërmjet ministrisë, federatave sportive, Universitetit të Sporteve, që një kuadër i edukimit fizik që del, në qoftë se ne do të hapim një klasë sportive, duhet ta çojmë në atë klasë sportive që ka infrastrukturën, pra një që mbaron për basketboll, do ta çojmë te kjo shkollë; një që mbaron për mundje te kjo shkollë, në mënyrë që këto klasa sportive, përvës 3-orëshit, të funksionojnë pasdite. Si është buxheti i këtyre orëve të mësimi pasdite? Prandaj, unë mendoj se nuk ka funksionuar. Ligji është bërë i mirë në letër dhe ndërsa ministrja përpiqet në komision të thotë se ka ecur, unë mendoj se nuk ka ecur ashtu siç duhet kjo reformë e sportit, për sa i përket orëve të mësimi, klasave sportive. Ka mungesë të një bashkëpunimi institucional ndërmjet disa institucioneve, që këto klasa sportive nuk mund ta bëjnë dot në kuadrin e edukimit fizik,

që thjesht ka mbaruar Universitetin e Sporteve, por duhet të jenë të specializuar për ato sporte që duam t'i rrisim, pra duke rritur masivizimin e pjesëmarrjes së nxënësve të shkollave.

Ne kemi bërë edhe një federatë sportive, që mund të them se nuk ka aktivitetin e duhur për brezin parauniversitar. Kemi edhe Federatën Parauniversitare. Pra, janë dy federata që duhet ta gjallërojnë sportin nëpër shkolla, për të bërë aktivitete ndërmjet shkollave në të gjithë Republikën, jo vetëm në Tiranë.

Mendoj se këtu duhet përqendruar fokusi, edhe juaji si institucion, që të bashkëpunoni me këta për të çuar ekspertë, për ta parë këtë reformë më në detaje se si duhet të funksionojë, se unë kam një përgjegjësi shumë të madhe para njerëzve të sportit, që me thonë: “Fidel, nuk po funksion ajo që ne besuam te ju si grup pune, si ekspertë, që u mblodhëm për të bërë këtë reformë dhe për t'ia paraqitur qeverisë”. Unë mendoj që ka një ngrirje. Nuk po flas për buxhetet që janë skandaloze, që me zor arritëm të shtonim 25 milionë këtë vit për sportin, që iu hoq sportit nga kompanitë e basteve.

Ju, si institucion, keni një rol shumë të rëndësishëm për ta nxitur më shumë ministrinë me ekspertë të ndryshëm dhe për të pasur një tavolinë të rrumbullakët institucionale.

Gerti Janaqi – Ne kemi qenë pjesë e hartimit të të gjithë programit të sportit, po flas për kohën e mandatit të parë qeverisës. Kemi qenë shumë aktivë me ato mundësitë që kemi pasur. Deri në momentin kur u hartua dokumentacioni, u shkrua programi, ashtu siç thatë që sporti është me 3 orë në javë e të tjera. Ka pasur rekrutime dhe u përmbushën rekrutimet. Vetëm në Tiranë janë punësuar rreth 700 mësues të edukimit fizik.

Atë që çalon, dhe unë këtu bashkohem me ju, nuk po hyj në pjesën e buxheteve, sepse nuk e kam këtë informacion, ndoshta do të duhet ta konsultojmë me ministrinë. Ndoshta ne do të duhet të punojmë më shumë, për mënyrën se si konceptohet nga një mësues i edukimit fizik një program i ri i kurrikulës së sportit. Perceptimet tona nuk janë thjesht perceptime në letër, por janë informacione të mbledhura, janë reforma me pyetësor online.

Një mësuesi i edukimit fizik mendon se, nëse sporti është 3 orë, nëse ai nuk ka terren sportiv ose fushë etj., etj., kjo nuk mund të bëhet. Ndërkohë, programi është konceptuar që jo detyrimisht të ketë vetëm lojëra me dorë apo përdorim të topit, por ka edhe spektrin e shëndetit etj., etj. Ndoshta këtu ne e marrim përgjegjësinë për ta thelluar akoma më shumë trajnimin e mësuesve të edukimit fizik.

Për klasën sportive unë di që ka një platformë të re, që është ndërtuar jo më shumë se para dy muajsh, por nuk e kam informacionin e detajuar që të hyj në një debat më profesional me ju.

Për sa i përket rekrutimit, prej vitit 2014 ne jemi pjesë e nëpunësit civil. Kemi tentuar disa herë të hapemi dhe kemi çuar thirrje kur kemi pasur mundësi, por janë konkurse që nuk i menaxhojmë ne, i menaxhon DAP-i dhe unë jo pa qëllim e përmenda që ndoshta një pjesë e institucioneve që kanë karakter shkencor dhe teknik, ndoshta duhet të punojnë me kod pune dhe jo me status nëpunësi civil.

Unë jam shumë i kënaqur nga një këndvështrim ndaj nëpunësve civilë. Po flas hapur, sepse nuk kam presion politik, pavarësisht se ky ka qenë një institucion që nuk është prekur nga politika. Në harkun e 20 vjetëve mund të ketë pasur lëvizje minimaliste, ndër 30 veta, mund të kenë qarkulluar 3 apo 4 persona dhe kjo i jep një lloj qetësie një drejtuesi. Por bashkohem me ju se, ndoshta, edhe niveli i specialistëve të sportit do të duhet të jetë më mirë i përzgjedhur, më qëllim që të mbushen gjithë këto boshllëqe...

Fidel Ylli – Po nuk po ndihet lëvizja fiskulturore sportive, nuk po ndihen aktivitetet. Unë këtu e kam merakun.

Duhet të bëjë shkolla aktivitet, duhet të lëvizin...

Milva Ekonomi – Te shkolla “Qendër komunitare” a ka ndonjë rol të veçantë kjo pjesa e sportit?

Gerti Janaqi - Shkolla “Qendra komunitare” e ka një nga komponentët kryesorë aktivitetin sportiv, por, siç ju thashë, e gjitha fillon nga mënyra se si kjo perceptohet nga mësuesi. Mos harroni se pas Institutit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, janë drejtoritë arsimore ato që kanë një rol kryesor dhe funksional. Pra, ata çdo porosi që marrin, duhet ta zbatojnë.

Milva Ekonomi – Atëherë, a keni bërë ju një renditje për drejtoritë arsimore me 4 apo 5 shkallë, të tipit “e keqe”, “disi e mirë”, “e mirë” apo “shumë e mirë”?

Gerti Janaqi – Ne kemi hartuar një raport, të cilin e kemi bërë edhe publik, por po e shpjegoj më mirë. Ky është raporti kombëtar për trajnimin e mësuesve, ku tregohet edhe renditja në çdo qytet, për shembull: sa mirë është Vlora, ku çalon puna në Fier, ku çalon puna në Kukës e të tjerë. Më shumë se sa përgjegjshmëria e një drejtorie arsimore, problemi kryesor me zyrat arsimore ka ndodhur në vitin 2009. Deri para vitit 2009 një drejtori arsimore apo një zyrë arsimore kishte në strukturën e saj specialistë kurrikule, pra që zbërthenin këto politika, siç e tha edhe zoti Fidel. Gjithashtu, kishte edhe inspektorë, të cilët dilnin në terren

dhe shikonin se si po implementohej kjo politikë. Pas vitit 2009, unë nuk e di se cili ka qenë ministër...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Nuk ka rëndësi.

Gerti Janaqi - Nuk kam asgjë me emrin, por dua të them se në vitin 2009, në kohën kur ministër ishte zoti Myqerem, u mor një model evropian, që ndoshta funksiononte në vende të tjera, por te ne nuk funksionoi, ku drejtoritë arsimore morën më shumë konceptin menaxherial me idenë për t'u dhënë liri shkollave. Pra, në këtë mënyrë u reduktua edhe numri i inspektorëve dhe sot që flasim, pothuajse nuk bëhet fare inspektim. Gjithashtu, u reduktua edhe numri i specialistëve që merreshin me kurrikulën. Sot ka më shumë ekonomistë dhe juristë sesa specialistë për arsimin. Këtë do ta rregullojmë...

Milva Ekonomi - Ky është riorganizimi...

Gerti Janaqi – Me riorganizimin, ne do të rrisim numrin e inspektorëve, sepse sot kemi vetëm 30. A e imagjinoni që sot kemi vetëm 30 inspektorë për 1600 shkolla?! Kjo histori ka ndodhur në vitin 2009, por numri do të shkojë në 560 inspektorë. Pra, me riorganizimin e ri, drejtoritë i rikthehen pak a shumë një formati klasik, por që ekziston edhe në Europë, sepse ne i kemi pare, dhe e tillë është në Skoci, në Francë, në Gjermani dhe në Itali. Pra, ne do të rikthejmë inspektimin në çdo zyrë arsimore. Zyrrat arsimore po rriten në numër dhe nuk janë më 38 drejtori dhe zyra arsimore, por numri do të shkojë në 58, sepse një fëmijë mund të jetë shumë i vogël për t'u futur në shkollë dhe mund të...

Dorina Rapti - Këta inspektorë mund të bëhen një pikë e fortë trajnimit.

Gerti Janaqi – Skema do të jetë e tillë dhe pikërisht ne këtë duam të synojmë.

Pra, ne synojmë që të bashkojmë IZHA-në me inspektoratin në një trupë të vetëm, në mënyrë që të ecim paralel. Pra, çdo gjë që prodhohet, të shikohet mirë dhe të inspektohet mirë. Sot që flasim, kjo gjë nuk ndodh. Pra, ne prodhojmë...

Milva Ekonomi – Kur mendoni se do të realizohet kjo gjë?

Gerti Janaqi – Unë jam interesuar dje dhe e kam ndjekur procesin, por ne kemi ecur deri në nivelin e propozimit si institucion varësie. Unë u konsultova me Drejtorinë Juridike të Ministrisë së Arsimit dhe të dyja VKM-të, edhe e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë, edhe e DAR-ve dhe zyrave arsimore, e kanë kaluar raundin e parë të marrjes së mendimeve nga ministritë. Pra, është dhënë *feedback*-u i parë dhe nga Drejtoria Juridike më kanë thënë se kanë një diskutim të fundit me Ministrinë e Financave, ku kanë diskutuar lidhur me buxhetin e të tjera. Sipas Drejtorisë Juridike besoj se...

Dorina Rapti – Ne riorganizmin e shikojmë si një emergjencë, sepse vjet, kur morëm mandatin, kemi thënë se do të jetë riorganizmi dhe ndarja në rajone...

Gerti Janaqi – Ne propozimet i kemi dërguar që para një viti dhe, sipas informacioneve që unë kam, Drejtoria Juridike e Ministrisë së Arsimit ka thënë se kanë pritshmëri që brenda muajit dhjetor të mbyllin raundi i dytë të diskutimeve dhe të kalojnë VKM-të ...

Milva Ekonomi – Ndërkohë, a keni bërë ju një kalendar, sepse indikatorëve të performancës, përgjithësisht, në momentin e miratimit të një VKM-je, u duhen 60 ditë kohë dhe pasi të miratohen, u duhen edhe 10 ditë të tjera. Atëherë, sa ditë do të duhen për ta implementuar? A keni bërë ndonjë gjë të përafërt?

Gerti Janaqi - Ne e kemi bërë tre herë kalendarin, por na është rrëzuar.

Milva Ekonomi – Unë nuk po pyes se kur, por në momentin që aprovohet, sa kohë ju duhet për t'u bërë gati dhe për ta implementuar në terren? A ju duhen 100 apo 300 ditë?

Gerti Janaqi - Unë mendoj se do të duhen rreth 100 ditë, në qoftë se DAP-i do të jetë operacional.

Milva Ekonomi – Pra, mbaron për tre muaj.

Bujar Çela – Kam një pyetje, a mundem?

Milva Ekonomi – Patjetër!

Bujar Çela – Në lidhje me organizimin e zyrave arsimore pranë bashkive, më duket se po e hedhim shumë larg topin.

Gerti Janaqi – Jo, ato varen nga ministria.

Bujar Çela – Ne zakonisht për të njëjtën gjë përdorim shumë terma dhe na duket sikur e dimë mirë shqipen, por, në fakt, gabojmë. Ne për aftësinë e kufizuar përdorim termin “aftësi ndryshe”, dhe hajdeni të gjejmë se cili ka të drejtë.

Kam përshtypjen se ne po e ndajmë keq këtë gjë, në kuptimin e mirë të fjalës, sepse decentralizimi duket i dëmshëm, por mua më duket se është edhe unifikues dhe duket sikur ka më shumë vlerë kombëtare. Kjo do të thotë se ne do të bëjmë 61 zyra arsimore për secilën bashki. A e keni të qartë se çfarë do të ndodhë me zyrën arsimore në Bashkinë Roskovec apo Bashkinë Patos?

Dorina Rapti – Po, ka edhe bashki...

Bujar Çela - Një sekondë, vajzë! Ju thoni se ka, por unë po të them se nuk ka. Ju deri tani thatë se do t'i bëjmë, kurse tani po më thua se ka. Program i ri është ky, që nuk e paskam lexuar?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A e kuptoni se çfarë masakre po bëjmë ne, pa u futur në politikë, sepse duam apo nuk duam, ne jemi pjesë e politikës dhe i kemi zënë këto vende.

Unë mendoj se duhet ta shikojmë më mirë këtë gjë, sepse ka edhe shkelje të gjuhës. Ne kemi kurrikula për çdo lagje dhe me zgjedhjen e teksteve që u bënë, ne krijuam një rrëmujë, të cilën...

Milva Ekonomi – Ndërkohë, duhet të adaptoheni, sepse nuk është më alarteksti...

Bujar Çela – Nuk e kam fjalën për alartekstin, por po përmend se çfarë ka ndodhur, sepse ne i krijuam vetë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Zoti Bujar, ti po merr disa shembuj, për të cilët edhe përfaqësuesit këtu nuk mund të të japin përgjigje...

(Diskutime pa mikrofon.)

Bujar Çela – Ne sot kemi shumë palestra, por kemi më shumë njerëz të shëndoshë. Ne sot duket sikur kemi teknologji shumë të zhvilluara, por fëmijët tanë nuk dinë të shkruajnë.

Milva Ekonomi - Ne duhet ta kemi të qartë se në momentin që mbyllet dera e klasës, mësuesi ose mësuesja është mbreti i klasës. Duke e pasur këtë gjë në mendje, e gjithë përpjekja jonë duhet të jetë të ky njeri, që është mbreti i klasës, në mënyrë që puna e tij të bëhet sa më bashkëkohore dhe sa më e lehtë për t'u koordinuar. Prandaj po kërkohen ndërhyrjet në sistemin e reformës parauniversitare, pikërisht për këtë gjë, sepse duhet të ketë edhe pak diversitet. Nuk mund të jenë të gjitha gjërat e unifikuara, sepse e bukura këtu qëndron, që të jetë pak e ndryshme...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo pjesë është e rëndësishme, që ta kuptojmë se duhet t'i lemë gjërat të zhvillohen, në mënyrë që zgjedhja të mos bëhet e vështirë, por mësuesi apo mësuesja që drejton një klasë të jetë mbreti i asaj klase dhe për këtë duhet të punojmë. Ndërkohë, e rëndësishme është se ka modele të ndryshme në botë dhe një ndër to është edhe ekonomia e dijes. Ne kemi thënë se fokusi i arsimit në Shqipëri do të jetë ekonomia e dijes. Ekonomia e dijes ka disa shembuj dhe në disa vende nuk e kanë sistemin e vlerësimit me notë, siç është Norvegjia. Anglia, për shembull, është komplet kreative dhe nuk ka rregulla si ne, kurse Franca është si ne, Belgjika është si ne, Italia është pak më keq se ne. Ndërkohë, reforma po bën pikërisht këtë gjë dhe ata kishin dëshirën e mirë për të provuar modele që vinin nga bota, por që nuk funksionuan në

Shqipëri. Ajo nuk ishte një dëshirë e keqe, por një dëshirë e mirë që nuk funksionoi. Tani unë kam përshtypjen se këta do ta kenë pak të vështirë të marrin një vendim, sepse hipotezën që kanë, duhet jo vetëm ta pilotojnë, por nga pilotimi duhet të shikojnë nëse do të dalë mirë apo jo, që të mos shkojnë përsëri te një model që nuk funksionon.

Gerti Janaqi - E gjithë ideja është se si e dërgojmë në inspektimin dhe trajnimin në shkolla. Kjo nuk ka qenë vetëm konsultë e grupit të punës në ministri, por edhe e DAP-it. Edhe nga Kryeministria ka pasur një ekip që është marrë me këtë punë, ku është konceptuar që një zyrë arsimore në një nivel bashkie, në raport me numrin e shkollave që ka territory, do të ketë numrin e punonjësve. Pra, do të ketë zyra me 10 persona, do të ketë zyra me 13 persona, me 17 apo me 21. Po marr rastin e Lushnjës, nëse në Lushnjë ka 80 shkolla, mund të ketë një zyrë me 17 persona; nëse Finiqi ka 2 shkolla, do të ketë një zyrë më të vogël...

Bujar Çela – A mund të më sqaroni, ju lutem, se ku do të ketë zyra arsimore dhe ku nuk do të ketë?

Gerti Janaqi - – Këtë po të sqaroj edhe unë: zyrat arsimore do të jenë në bazë të numrit të shkollave.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Tani, unë ndihem si në shtëpinë time këtu, pasi kam pasur fatin që jem bashkëpunëtor prej 7-8 vjetësh, që në vitin 2011, dhe derisa të mbaroj mandatin. Në drejtim të përshkrimit, të kurikulave, të hartimit, sidomos në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare...*(Nuk dëgjohet)*

Ju falënderoj për ekspozenë që bëtë, për punën e këtyre njerëzve që punojnë në këtë institucion, të cilët jo vetëm kanë fituar eksperiencë, por punën e tyre e kanë reflektuar në arritjet e programit dhe në reformat. Tani ne kemi një ligj të ri të arsimit të lartë, kemi ndryshime përkatëse në arsimin parauniversitar, por këto nuk do të kishin vlerë pa këta njerëz, që si milingonat kanë punuar dhe kanë marrë një eksperiencë të mirë me programet më të mira, sidomos në shkrimin e kurikulës kombëtare. Më vjen mirë për këto që janë arritur për arsimin universitar dhe për të gjithë nivelin që nga arsimi bazë tek ai i mesëm.

Për sqarim, gjatë dëgjësës që kemi bërë me zonjën Lindita, në arritjet për kurikulën e re, ka mbetur vetëm klasa e pestë. Si është situata dhe cila është pritshmëria për t'u mbyllur komplet kurikula?

Pyetja e dytë, në kurikulën e re të arsimit bazë, por edhe atij të mesëm janë futur programe, që kanë dalë edhe nga testet e mësuesve dhe nxënësve, në lidhje me edukimin

mjedisor dhe sigurinë, që shumë shkolla dhe shumë programe në botë, por edhe në vendet të rajonit e kanë edukimin mjedisor dhe sigurinë e jetës.

Pyetja e tretë, lidhur me kurikulën arsimore që ka për bazë kompetencat gjatë shkrimit të skeletkurikulës dhe moduleve, duke u nisur edhe nga ajo që tha Fideli në fillim, keni parashikuar që kurikula jonë ka për bazë kompetencën, por ku do të realizohen praktikat?

Ne kemi një fenomen, sidomos në shkolla, që nuk ka mësues për fizkulturë dhe për muzikë në zonat rurale dhe ju e dini më mirë që aplikohen mësues me kontratë provizore...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një nismë e mirë ishte rritja e mesatares për programin e mësuesisë, deri në 7 dhe nxitja e studentëve ekselentë që merret si kusht financimi i arsimit.

Në fund e kam për tekstet bazë të shkencave natyrore, të cilat kanë për bazë programet e shkollave të Oksfordit, Kembrixhit ... gjatë hartimit të skeletkurikulës dhe moduleve, a janë bërë në konvergjencë të plotë të këtyre teksteve apo janë shkruar dhe tani vonë është korrigjuar ?....

Vilma Bello – Mund t'i bëj them edhe unë tri pyetjet e mia dhe t'i përmbledhim të gjitha bashkë.

Flitet për trajnimin e mësuesve ndihmës. Kemi parasysh që ka pak programe dhe kurikula në institucionin e arsimit të lartë që nxjerrin mësues të licencuar për fëmijët me aftësi ndryshe. Cili është profili i atyre mësuesve që do të përfshihen në këtë grupim, sepse nuk i mbulojnë dot me programet dhe kurikulat ata mësues që dalin? Pra, cili profil mësuesish do të përfshihet, sepse unë jam në dijeni që janë përfshirë mësues të ciklit të ulët dhe gjuhë-letërsisë, të cilët, në më të mirën, janë marrë nga portali dhe, në më të keqen, nuk është menaxhuar kështu, sepse ka pasur zgjedhje të caktuara.

Pyetja e dytë. E di që ka nisur një proces për unifikimin e programeve të mësuesisë në institucionet e arsimit të lartë. Një proces i tillë është bërë në vitin 1998 në Universitetin e Vlorës, në fillimet e programeve dhe ka qenë në masën 70%, që t'i lihej 30% dinamikës së çdo institucioni. Pra, sa do të jetë përqindja dhe kur mbaron procesi i unifikimit të këtyre programeve?

E fundit, vëmendja ime është edhe te Shkolla e drejtorëve. Si janë përzgjedhur drejtorët që do të marrin pjesë? A janë apriori drejtorët që janë aktualisht, të cilët do të marrin pjesë dhe pastaj do të kalojnë në një filtër të hollë nëpërmjet kësaj shkolle, nëse do të licencohen për drejtor apo jo dhe cilët janë mësuesit e tjerë? Nëse ka mësues të përzgjedhur,

kush i ka përzgjedhur këta mësues për të marrë pjesë në “Shkollën e drejtorëve”? Këtë pyetje e bëj nisur nga një situatë e pakëndshme nga një informacion që kam marrë.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Së pari, dua t’ju falënderoj për ekspozenë që bëtë dhe të shpreh dhe keqardhjen për kushtet që nuk i keni fare të mira.

Pyetjen e parë e kam në lidhje me pyetjen që bëri Fideli, ngarkesa që ka mësuesi me profesionet përkatëse. Lëndët dytësore, kryesisht muzika, edukimi fizik e të tjera, kthehen në orë plotësuese. Si duhet të kombinojmë profesionalizmin me shqetësimin që ka sot shkolla me klasat kolektive?

E dyta, unë nuk heq dot një paralele, sepse vetëm tre vjet kam punuar si mësues në jetën time, por ne ishim të abonuar te revista pedagogjike, që e botonte Instituti i Studimeve Pedagogjike dhe abonoheshim në disa metodika të mësimeve të hapura apo të formave më të mira që qarkullonin. Sot bëjnë trajnime të tipit *online* ose në salla, apo mësuesit kanë dokumentacion shtesë dhe japin provime shtesë, të cilat vetëkualifikohen ose kanë një lloj detyrimi, jo thjesht këto axhendat publike, që quhen trajnime apo kualifikime?

Milva Ekonomi – Dua të bëj edhe unë një pyetje, dhe e kam për kurikulën, që është një shqetësim, i cili na ka ardhur në komision. Si organizohet kurikula, se shumë shpesh ka ankesa nga prindër që kanë fëmijët nëpër shkolla, të cilët për të bërë një detyrëprojekt, detyrohen të punojnë me disa materiale që mund të jenë dokumente shkencore dhe një fëmijë i moshës 10 vjeç, pra në klasën e pestë ose të gjashtë, e ka të vështirë ta kuptojë dhe duhet gjithmonë ndihma e prindit që ai ta kuptojë.

Gerti Janaqi – E keni fjalën për projektet?

Milva Ekonomi – Po, për projektet, si janë udhëzimet për këtë gjë dhe pse ka paqartësi aty?

A ka pyetje të tjera?

Almira Xhembulla – Dua të di se si ecet me monitorimet, kur ka shqetësime të tipit që kurikula ka problem, por edhe nisma që ju keni marrë, por edhe *feedback*-u që merret dhe sa është koha e reflektimit të ndryshimeve? Pra, si funksion kur ka shqetësime të tilla?

Gerti Janaqi – Përgjigjet po i filloj nga dy pyetjet e fundit. Unë jo pa qëllim prezantova skemën se si shpërndahet informacioni, i cili është i dizenuar mirë por has në vështirësi. Prandaj kërkujmë sa më shpejt ristrukturimin e DAR dhe ZA-së, sepse mungon ai ingranazhi i mesit, që e lehtëson të gjithë procesin.

Ne bëjmë matje vjetore. Për shembull, kjo është e vitit 2017 dhe është perceptimi i mësuesve dhe prindërve mbi të gjitha këto që po diskutojmë. Ne kemi ndërthurur kurikulën e klasës së 5-të dhe vitin tjetër mbyllet e gjithë kurikula, pra botohen edhe tekstet e klasës së 5-të dhe ajo që kuptojmë është ndërrimi i qasjes, për të sqaruar mikrodetajet dhe mikroelementet.

Në rastin konkret për portofolin, Dorina mund t'ju japë shpjegime, ne nxjerrim manuale, të cilat shpjegojnë në mënyrë të detajuar trajnimet për specialistë të DAR-it, ZA-ve dhe drejtorëve të shkollave. Por nuk duhet mjaftuar me kaq, sepse herë pas here edhe kalimi në një qasje të re është i vështirë për mësuesit; duhet të imagjinojmë që pas 45 vjetësh të ndërrojmë një mendësi pune është e vështirë. Prandaj jo pa qëllim e përmenda që duhen rreth 10 apo 15 vjet punë. Por nga viti tjetër ne do të fillojmë punën me nivele më të imta për të sqaruar këto defekte, që janë të vogla, si: vlerësimi nuk është kuptuar mirë, disa mendojnë që është hequr nota fare; dosja e portofolit të fëmijëve që është tendencë europiane, që është punimi i një fëmije dhe e ruan, aty ka një numër limit me një ose dy, por ka mësues që kërkojnë detyra pafund. Por kjo do të thotë më shumë shpenzim për buxhetin e familjes, sepse do të printojnë, do të shkojnë në internet e të tjera. Po mundohemi që i gjithë ingranazhi të funksionojë në një informacion të centralizuar, prandaj na duhen inspektorët dhe forumet online.

Milva Ekonomi – Më falni që po ju ndërpres, a keni ju një *website*?

Gerti Janaqi – Ne kemi një *website* dhe e kemi shumë aktiv.

Milva Ekonomi – A ka *frequently ask question* nga mësuesit atje?

Gerti Janaqi – Ne kemi edhe faqe *facebook-u*, ku marrim pyetje; kemi edhe një kanal në *youtube*, ku hedhim filmimet reale se si bëhet një orë mësimi në klasa. Prandaj jo pa qëllim thashë që është një instrument, por jo i vetmi. Pra, në termat e teknologjisë ne po përpiqemi maksimalisht. Të njëjtin ritëm unë dua ta ketë edhe Inspektorati i Arsimit, që nuk e ka pasur. Nuk mund të flas këtu, sepse ka edhe specialistë, por është peshqesh nga “Aleati”. Specialistët dalin në terren, edhe sot që flasim, dhe punojnë me dispozita të normativave të vjetra dhe krijojnë tension me mësuesit. Prandaj duhet të ndodhë sa më shpejt ristrukturimi, në mënyrë që të jemi më shumë të përqendruar dhe të unifikuar në qëndrim.

Çështja e mësuesve, unë për shembull kam monitoruar Dibrën, po marr një qark, i cili ka nevojë imediate, të mos them që është thelluar hendeku, për 250 mësues, të profilit të sportit, të arteve dhe në portalin “Mësues për Shqipërinë” aplikojnë 50 veta. Është i gjithë procesi i migrimit, që do të duhet të na bëjë të reflektojmë, për të krijuar një program

financiar për të çuar njerëz, sepse kemi vakanca në jug e veri, edhe në Tiranë, sepse të gjithë aplikojnë në Tiranë dhe Durrës. Kështu, për shembull, nga 5000 aplikantë në portalin “Mësues për Shqipërinë”, 3500 janë aplikime për në Tiranë, Durrës dhe Fier, ndërkohë që veriu dhe fshatrat e jugut janë bosh.

Milva Ekonomi - Ka probleme me shpërndarjen.

Gerti Janaqi - Unë po thosha tjetër gjë, për shembull, sot Dibra ka 250 vende pune, ku punojnë mësues që nuk kanë arsimin përkatës. Po t'i heqë drejtori, nuk ka se me çfarë i plotëson, sepse aplikime për të punuar në Dibër ose në fshatrat e Bulqizës janë 50. E njëjta situatë është edhe për fshatrat e Gjirokastrës. Atëherë duhet të dalim me një trajtim financiar, një skemë të ngjashme me atë të mjekëve.

Fideli Ylli— Po çfarë interesi ka të shkojë në majë të malit?

Gerti Janaqi – Patëm një mbështetje nga ambasada franceze dhe na treguan si e kishte zgjidhur Franca. Në ministri shkonte lista nga portali, dhe ministria i thoshte aplikantit që shteti francez ka nevojë që të punosh në Monpelie, jo në Paris, sigurisht me një tarifë respektive, bonuse e të tjera. Ama, nëse ti nuk pranoje, të vinte radha pas 5 vjetësh për punë. Kjo natyrisht do buxhet dhe një paketë financiare.

Gjithashtu, kemi pasur një shqetësim nga Universiteti i Arteve, sepse me llojin e diplomës që ata merrnin, nuk hynin dot në sistem, pasi ligji është shumë rigoroz në marrjen e licencës së mësuesit. Këtë mendoj se e kemi zgjidhur. Kemi punuar bashkë me një grup nga Akademia e Arteve, iu kemi dhënë shansin që ata të plotësojnë 20% të krediteve që duhet t'i kenë në pedagogji dhe ata kanë filluar që edhe brezat që janë diplomuar ta marrin këtë 20%-sh dhe hyjnë në provimin e licencës.

Fidel Ylli- Po që nuk ka studentë për muzikë, a e dini? Që orkestra në një të ardhme nuk do të ketë muzikantë, sepse edhe ata që kanë qenë, kanë ikur, ndërsa këtu vetëm një student i bie trombonit ose një vegje tjetër, që nesër do të duhet për Orkestrën e Radiotelevizionit, ose të Teatrit të Operës. Nuk ka studentë në këtë degë. Duhet të gjenden forma, siç kanë qenë dikur pallatet e pionierit.

Gerti Janaqi- Ligji i arsimit të lartë iu jep pavarësi të plotë universiteteve. Nëse vjen nga fakulteti i shkencave sociale, ka mbaruar psikologji, ka studiuar jashtë, por me këtë tagër që ka ligji, me këtë lloj pavarësie, kam frikë se pedagogët ose universitetet nuk e kanë kuptuar që kanë lirinë për të qenë ata atraktivë. Universitetet tona hapin programe kot, që nuk kanë lidhje me tregun e punës. Pra, unë dua të them se Akademia duhet të jetë më atraktive.

Fidel Ylli – Unë mendoj se të shkosh në akademi duhet të jesh që pionier, që të kesh filluar karrierën; akademia është fundit, aty ku duhet të marrësh diplomën. Po nuk diti t'i bjerë veglës që fëmijë, si do të shkojë në akademi të bëhet muzikant?

Gerti Janaqi – Unë po them se ka disa momente ku është ndërhyrë në arsimin parauniversitar, sepse fillon teatri, drama, muzika. Janë ndryshuar kurrikulat, pra në parauniversitar ndërhyrjet janë bërë. Unë mendoj se universitetet duhet të fillojnë të marketojnë veten. Ka tentativa, për shembull, panairot, ofertat për maturantët.

Milva Ekonomi- Ndërhyrja e bërë nga Fideli është kjo që, kur ne kemi qenë të vegjël, ka pasur shtëpi pionieri, ku zhvillohej një talent, për shembull, piano, alpinizëm e të tjera.

Gerti Janaqi – Po sot ky është roli që kanë QKF-të.

Fidel Ylli - Në Amerikë, për shembull, fëmijët e vegjël e kanë me detyrim të mësojnë një vegël muzikore dhe një sport.

Gerti Janaqi – Unë jam dakord, por mendoj se duhet fuqizuar roli i QKF-ve, që varen nga bashkitë.

Kemi kaluar edhe një pikë në ligjin e arsimit parauniversitar, që ka të bëjë me lirinë e buxhetit financiar, që do të menaxhojë një drejtor shkolle. Këtu duhet punuar pak më shumë, që një drejtor shkolle ta kuptojë që ka liri dhe fonde për të hapur një klub sporti. Vilma bëri një pyetje me shumë vend, në fakt, nuk është vetëm problem i Shqipërisë, por i të gjitha vendeve të rajonit për mësuesit ndihmës, numër, i cili ishte zero, por është rritur në 700. Jashtë Shqipërisë janë mbyllur shkollat speciale dhe ata njerëz që kanë punuar në shkollat special, janë integruar në arsimin parauniversitar. Kjo nuk ndodh te ne, sepse ne i kemi shkollat speciale. Po e them me zë të ulët se ne jemi kundër rryme në qasjen e madhe si funksionon jashtë. Megjithatë, ka përpjekje nga universitetet për të hapur programet, për shembull, universiteti i Elbasanit, i Tiranës. Pra, ne po stimulojmë universitetet që të hapin masterë në këtë drejtim. Po përpiqemi që boshllëkun ta përmbylim me profile të shkencave shoqërore dhe jemi në bisedime me ambasadën italiane, sepse ata kanë marrë përsipër trajnimin e mësuesve ndihmës në universitetin e Bolonjës dhe Milanos. Po përpiqemi të kontaktojmë edhe me ambasadat e tjera, por kjo do kohë.

Zëvendësministria jonë, Besa Shahini, është në kontakte me universitetet e Zyrihut dhe Lozanës, të cilëve iu kemi kërkuar asistencë për studentët me aftësi të kufizuara, por edhe për problem të tjera, që lidhen me reformën e mësuesve.

Desha t'ju jap edhe një lajm të fundit, ne zakonisht kemi qenë në tryzni edhe nga ministri të tjera, sepse çdo ministri ka pasur reformat e veta, por kurrikula nacionale është një pikë hyrjeje e manualeve të ndryshme, këtu po përmend strategjinë antikanabis. Kemi një bashkëpunim me ministrinë e linjës për emergjencat dhe sigurinë në shkollë, që është manual që ka hyrë në shkollë; kemi edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm, që është e re, ka hyrë në program dhe e firmosur nga ministri. Pra, bashkëpunimin me ministrinë e kemi. Sipas mendimit tim, sfida nuk është shkrimi i dokumenteve, por interpretimi në terren.

Milva Ekonomi- Ju thatë që keni këtë botimin vjetor që është perceptimi i mësuesve dhe prindërve dhe treguat kundërrymën për shkollat speciale. Sipas vëzhgimeve që janë bërë, thuhet se shqiptarët janë paragjykses ndaj varfërisë, domethënë për ne një njeri i varfër është si i lënë mënjane, pavarësisht se mund të ketë talent. Po për pjesën e paaftësisë a dini ju si reagojnë shqiptarët?

Gerti Janaqi – Nuk kemi matje.

Milva Ekonomi - Unë mendoj se duhet të bëjmë diçka me prindërit. Unë kam qenë te shkolla “Kosova”, ngjitur kam pasur Shtëpinë Fëmijës, dhe kishim detyrë një herë në javë të merrnin mik në shtëpi nga fëmijët e Shtëpisë së Fëmijës. Nuk e di sot a është pjesë e edukimit në shkollë marrëdhënia me fëmijë të tillë?

Ajo që pashë në gazetë është se shqiptarët përçmojnë të varfrit.

Gerti Janaqi - Unë do të thosha që ka iniciativa nga Drejtorinë Arsimore për shkëmbime të tilla dhe quhen projekte ekstrakurrikulare, ku u jepet liria që të bëjnë herë pas here shkëmbime, për shembull, Berati është binjakëzuar me Rrëshenin, ashtu siç ka ndodhur me Kosovën, ku është klasifikuar në harkun e 4 vjetëve lëvizja brenda Shqipërisë. Janë parashikuar edhe në letër, por nuk kemi matje specifike.

Dorina Rapti - Në lidhje me këtë gjithpërfshirje janë bërë shumë, por nuk kemi matje. Unë mendoj se nga takimet që kemi bërë me mësuesit, ka ndryshuar qasja e perceptimit që kanë nxënësit, kur kanë një fëmijë ndryshe në klasë. Nuk kemi bërë matje konkrete, por trajnimet kanë qenë në fokus të punës sonë.

Milva Ekonomi- Faleminderit!

Por ne do ta lëmë të hapur takimin për të ardhur edhe herë të tjera, kur të vijë edhe opozita, mbase.

Gerti Janaqi- Faleminderit!

Jeni të mirëpritur. Edhe për ne ishte kënaqësi.

MBYLLET MBLEDHJA

.